

DETYRE PROJEKTIMI

Për objektin;

Studim Projektim per “Ndërtim dhe Shtim I kapacitetit të sistemit të furnizimit me ujë në blloqet Nr 1, 2,3 dhe 4 në lagjen Mar Lula, Shkodër”

SHKODER 2024

1. Përmbajtje

I. DETYRA E PROJEKTIMIT	3
II. OBJEKTIVI	10
III. QELLIMI I PUNES	10
IV. TE DHENAT PER PROJEKTIM	11
V. KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI	11
VI. DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT	15
VII. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT	19
VIII. MËNYRA E PAGESËS	20

I. DETYRA E PROJEKTIMIT

OBJEKTI: Studim Projektim per "Ndërtim dhe Shtim I kapacitetit të sistemit të furnizimit me ujë në blloqet Nr 1, 2,3 dhe 4 në lagjen Mar Lula, Shkodër"

VEND NDODHJA: Njesite Administrative Shkoder, qyteti Shkoder.

QELLIMI:

- Furnizimi me uje 24 ore i 4 blloqeve te lagjes Mar Lula i njesise administrative Shkoder kjo edhe per 20-25 vite.
- Shtim i kapacitetit te furnizmit e uje per 2 blloqe banimi (blloku nr.2 dhe blloku nr.3) te cilat kane rrjet ekzistues.
- Ndertim dhe trasim i linjave te reja te furnizmit e uje per 2 blloqe banimi (blloku nr.1 dhe blloku nr.4) dhe instalimi i matesve zonal.
- Sigurimi i nje skeme te projektuar per operim me eficence te larte ne raport me skemen aktuale te sistemit te furnizmit me uje te qytetit;
- Projektimi i rrjetit shperndares per te siguruar uje ne lidhjet e konsumatoreve me presion minimal prej 2 bar dhe maksimal 6.0 bar, me uje me cilesi sipas Standarteve Shqiptare dhe udhezimeve te EU;
- Paisja e cdo objekti dhe familje me mates uji qe lejon kontrollin dhe operimin ne te ardhmen me sistemin SKADA .
- Instalimi i hidranteve te zjarrit.

TE DHENAT KRYESORE:

Hartimi i projektit të objektit: **Studim Projektim per “Ndërtim dhe Shtim I kapacitetit të sistemit të furnizimit me ujë në blloqet Nr 1, 2,3 dhe 4 në lagjen Mar Lula, Shkodër”** sipas VKM Nr. 354 date 11.05.2016.

PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES EKZISTUESE:

Shkodra është qytet dhe bashki në Shqipërinë Veriperëndimore e qendra e rrethit dhe qarkut me të njëjtin emër. Është një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë, me një histori banimi mijëvjeçare në qytet dhe krahinë. Bashkia e Shkodrës shtrihet përgjatë fushës së Mbishkodrës midis pjesës jugore të liqenit të Shkodrës dhe ultësirës së Alpeve Shqiptare në brigjet e lumenjve Buna, Drin dhe Kir. Shkodra është bashkia e pestë më e populluar në Shqipëri. Aktualisht nga te dhenat e marra nga UKSH u shërben rreth 209,000 banorëve, prej të cilëve 55 % jetojnë në zona urbane. Shkalla totale e mbulimit të shërbimit të furnizimit me ujë në

zonën e shërbimit është 57%, dhe shërbimi i grumbullimit të ujërave të zeza është 45%. Në zonat urbane mbulimi me ujë është 80%, ndërsa në zonat rurale shkalla e mbulimit bie në 19%.

Furnizimi me ujë i zonës urbane të Shkodrës sigurohet nëpërmjet stacionit të puseve të Dobraçit, i vendosur në pjesën veriore të qytetit, rreth 3 km nga qendra e qytetit, midis lumit Kir dhe liqenit të Shkodrës. Në stacionin e pompimit të Dobraçit gjenden 11 puse, 10 prej të cilëve janë në funksion. Këta puse janë ndërtuar në vitin 1965 dhe janë rinovuar në vitin 2010. Uji i pompuar nga çdo pus dërgohet në rezervuarin e ndërmjetëm me kapacitet 1000 m³ dhe 200 m³, nëpërmjet gypave/tubave DN 250 në tubacionet DN 400 në një distancë prej 150 metrash deri në 1 kilometër. Vlen të theksohet se në NjA Rrethina janë bërë ndërhyrje/lidhje të paautorizuara në linjën e transmetimit nga stacioni i pompimit në pusin shpërndarës Dobraq. Për qytetin e Shkodrës, kapaciteti i prodhimit të ujit është afërsisht 500-600 l/s. Rrjeti kryesor i transmetimit është 5 km tubacione DN 400 mm nga stacionet e pompimit të Dobraçit deri në rezervuarin në Tepe. Shqetësimi kryesor janë lidhjet e paautorizuara dhe rrjedhjet e rrjetit, prandaj kërkohet investim për riparimet. Qyteti i Shkodrës ka në funksion tre rezervuarë me një vëllim total prej 13,800 m³ të cilët ndodhen në kodrën e Tepes.

Rezervuari	Kapaciteti (m ³)	Statusi
R1	2,000	Jashtë funksionit
R2	1,800	Në funksion
R3	4,000	Në funksion
R4	8,000	Në funksion
Totali (funksionimit)	13,800	

Rezervuarët e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit UKSH

Për momentin vetëm rezervuari R4 furnizon qytetin e Shkodrës. Rezervuari R2 furnizon zonat e Ajasem dhe Lugun e Çesme dhe rezervuari R3 furnizon me ujë zonën përreth kodrës së Tepes.

1.1.Sistemi i Furnizimit me ujë për lagjen Mar Lula



A. Blloku nr.1- ka mundësi të rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë.

B. Blloku nr.2- në këtë bllok ekziston rrjeti shpërndarës I brendshëm dhe aktualisht banoret furnizohen me ujë, por raporti midis kërkesës për konsum dhe furnizimit është I pamjaftueshëm. Përgjatë sezonit të verës kanë orare shumë të limituara dhe sasia që vjen nga rrjeti i ujejsllesit mbulon vetëm nevojat për të pirë.

C. Blloku nr.3- në këtë bllok ekziston rrjeti shpërndarës I brendshëm dhe aktualisht banoret furnizohen me ujë, por raporti midis kërkesës për konsum dhe furnizimit është I pamjaftueshëm. Përgjatë sezonit të verës kanë orare shumë të limituara dhe sasia që vjen nga rrjeti i ujejsllesit mbulon vetëm nevojat për të pirë.

D. Blloku nr.4- ka mundësi të rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë.

Aktualisht ky sistem i furnizimit me ujë administrohet nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkoder.

1.2.Rrjeti Shpërndarës i Ujit. Gjendja ekzistuese.


Gjendja ekzistuese e furnizimit me ujë të bllokut nr.1 dhe bllokut nr.2 të lagjes Mar' Lula është investuar në vitet e fundit dhe banoret janë të lidhura në sistemin e shpërndarës të furnizimit me ujë të qytetit dhe i kanë të vendosur kasetat me matës individualë. Aktualisht një nga njëmbëdhjetë pompat shërben vetëm për furnizim me ujë të rezervuarit të ri nr.1 në Tepe me $V=8000 \text{ m}^3$ i ndërtuar në vitin 2000. Nga dy stacione pompimi në rezervuarin e ujit pompohet direkt në rrjetin e shpërndarjes së qytetit. Rrjeti kryesor i transmetimit përbëhet nga 5 km tubacione DN 400 mm nga stacionet e pompimit të Dobraçit deri në rezervuarin në Tepe me volum 8000 m³. Rrjeti i shpërndarjes së qytetit përfshirë dhe 2 blloqet e lartpërmendura janë me materiale të ndryshme, por materialet më të përdorura janë çeliku dhe HDPE. Të gjitha linjat e reja që janë ndërtuar së fundmi janë HDPE. Qyteti i Shkodrës

furnizohet me ujë 24 orë në ditë. Sasia e ujit që furnizon qytetin është e mjaftueshme, por ka problemet si vijon:

- Furnizimi bëhet duke pompuar direkt në rrjet
- Humbjet në rrjet janë të pranishme për shkak të vjetërsimit dhe amortizimit
- Përdorimi i rezervuarit të Tepes vetëm në momentet e pikut do të thotë që presioni

është shumë i ulët (afërsisht 1,5 - 2 bar), gjë që i detyron klientët të përdorin pompa. Klientët në Shkodër nuk përdorin depozita personale. Qyteti i Shkodrës ka në funksion tre rezervuarë me një vëllim total prej 13,800 m³ të cilët ndodhen në kodrën e Tepes.

Blloku nr.1 dhe blloku nr.4 aktualisht nuk kane rrjet furnizimi me uje dhe as kanalizime.



Rrjeti ekzistues i ujësjellësit të qytetit të Shkodrës

Me poshte jepet gjendja ekzistuese e 4 blloqeve ne studim.



Foto ne bllokun nr.3 (matesat e vendosur me kasete,rruget me asfalt)







Foto ne bllokun nr.1 (konturi kufizues me lumin)



1.3.Popullsia. (numri i banoreve, konsumatorit e tjere)

Nisur nga kërkesa për ujë të pijshëm cilësor për 24 orë, si dhe zhvillimet në zonë gjatë 25 viteve të fundit është e domosdoshme studimi dhe projektimi i nderhyrjeve të nevojshme për të siguruar orët e furnizimit me ujë, si dhe reduktim të humbjeve në rrjet. Këto nderhyrje pritet të japin një ndikim të drejtëpërdrejtë në cilësinë dhe sasinë e furnizimit me ujë të lagës Mar Lula duke e kompletuar qytetin e Shkodrës me rrjet të furnizimit me ujë. Referuar të dhënave të këtyre blloqeve, ndikimi i kësaj nderhyrjeje do të jetë në zonat e dhëna në tabelën mëposhtme.

Njësia Administrative Shkoder	Konturet kufizuese të projektit		Nr i objekteve/ banoreve aktiv	
Blloku nr.1	42° 3'30.44"N	19°31'29.37"E	356 objekte/ 1'068 banore	
	42° 3'17.97"N	19°31'43.47"E		
	42° 3'20.76"N	19°31'46.69"E		
	42° 3'26.28"N	19°31'45.21"E		
	42° 3'38.91"N	19°31'48.59"E		
	42° 5'8.25"N	19°32'6.77"E		
	42° 5'8.11"N	19°32'4.80"E		
	42° 4'44.53"N	19°31'55.58"E		
	42° 4'44.36"N	19°31'51.80"E		
	42° 4'42.45"N	19°31'51.62"E		
	42° 4'42.12"N	19°31'49.59"E		
	42° 4'31.40"N	19°31'46.29"E		
	42° 4'27.71"N	19°31'45.48"E		
	42° 4'21.58"N	19°31'44.73"E		
	42° 4'18.57"N	19°31'40.17"E		
	42° 4'11.33"N	19°31'43.69"E		
	42° 4'5.70"N	19°31'40.98"E		
42° 4'3.13"N	19°31'36.70"E			

Blloku nr.2	42° 3'58.80"N	19°31'38.63"E	321 objekte/963 banore	
	42° 3'40.56"N	19°31'33.81"E		
	42° 3'41.21"N	19°31'25.61"E		
	42° 3'43.28"N	19°31'25.72"E		
	42° 3'54.13"N	19°31'20.15"E		
Blloku nr.3	42° 3'9.52"N	19°31'29.30"E	238 objekte/ 714 banore	
	42° 3'13.20"N	19°31'21.46"E		
	42° 3'30.44"N	19°31'29.37"E		
	42° 3'24.17"N	19°31'42.67"E		
	42° 3'17.97"N	19°31'43.47"E		
Blloku nr.4	42° 2'55.09"N	19°31'18.71"E	52 objekte / 156 banore	
	42° 3'2.21"N	19°31'16.13"E		
	42° 3'13.20"N	19°31'21.46"E		
	42° 3'9.52"N	19°31'29.30"E		
		Total	967 objekte / 2901 banore	

II. OBJEKTIVI

Objektivi i detyres së projektimit është hartimi i projektit për **“Ndërtim dhe Shtim I kapacitetit të sistemit të furnizimit me ujë në blloqet Nr 1, 2,3 dhe 4 në lagjen Mar Lula, Shkodër”**, sipas planimetrisë bashkëngjitur kësaj detyre projektimi.

Ndërhyrja në këtë zonë do kryhet për:

- Furnizim me ujë i lagjes Mar Lula,
- Përmirësim i orarit të furnizimit me ujë ne 24 orë,
- Përmirësimin e sasisë së ujit për frymë,
- Përmirësimin e cilesisë së ujit,
- Ulje te humbjeve ne rrjet ,
- Te sigurohet sasia e nevojshme e ujit per numrin e popullsise ne prespektive.
- Te arrihet qendrueshmeria e projektit ne aspektin mjedisor, social dhe ekonomik.

III. QELLIMI I PUNES

Per realizimin e projektit, projektuesi duhet te rishikojte te gjithe informacionin ekzistues lidhur me projektin qe duhet te hartojte per arritjen e objektivit dhe furnizimit me uje sipas detyres se projektimit dhe te konsultohet me njesine e qeverisjes vendore qe ka nen administrim, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkoder, OSSHE dhe shoqerite e shperndarjes se internetit ne zone.

Studim -projektimi duhet te kete cilesi te tille ku nepermjet tij te plotesohet standarti i kerkuar dhe te plotesoje kushtet e projektimit. Projekti te parashikojte zgjatjen e tubacionit dhe linjave te shperndarjes ne afersi te tille qe te mund te kete akses lidhjeje per te gjitha banesat ne pusetat perkatese.

Po ashtu duhet të parashikohen dhe matësat e rinj ne pikat hyrese dhe ne linjat kryesore ne menyre qe te evitohen sasi te humbjeve te ujit midis linjave te dergimit. Ne keto njesi te parashikohet edhe mundesia per lidhje me sistemin e monitorimit online te tyre dhe lidhje me SCADA ne te ardhmen.

IV. TE DHENAT PER PROJEKTIM

1. Popullsia aktuale e lagjes Mar Lula ne studim eshte e perbere nga rreth 2000 familje
2. Shtesa natyrore e popullsisë te merret bazuar ne te dhenat e INSTAT për vitet ne vazhdim.
3. Perspektiva e ujesjellesit te parashikohet per 25 vjet.
4. Norma per fryme te popullates te llogaritet sipas normave dhe ligjeve ne fuqi. Norma e ujit te pijshem per banore ne banesa do te merret 300 l/dite per banorë.
5. Materiali i tubacionit te jete prodhim EU, 100% dhe i certifikuar per uje te pijshem. Materialet e tubacioneve qe do te perdoren te jene tubacione te polietilene HDPE me densitet te larte.
6. Presioni ne rrjetin shperndares ne piken me te disfavorshme dhe me te larget do te jete jo me pak se 2 atm per furnizimin me uje te godinave dhe objekteve social-kulturore.
7. Humbjet ne rrjet ne perspektive do te merren 20%.

V. KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI

Projekti yne si kerkese kryesore ka realizimin e nje rrjeti te ri te furnizimit me uje per blloqet 1,2,3,4.

Ne mbeshtetje te skemes ekzistuese Operatori Ekonomik "OE" duhet qe pasi te njihet me skemen ekzistuese do te veproje ne plotesimin e saj me eficence, kjo skeme jepet ne figuren me poshte.

Problematika e bllokut nr.2 dhe bllokut nr.3 lidhur me shtimin e kapacitetit te furnizimit me uje ne rrjetin ekzistues do ti jape zgjidhje edhe bllokut nr.1 dhe bllokut nr.4 duke perdorur nje tubacion kryesor i cili eshte menduar te lidhet tek puseta shperndarese ne Rus (42° 4'41.45" N, 19°30'54.01"E) dhe te trasohet pergjate unazes Lindore paralelisht me 2 tubacionet Ø110mm. Ky tubacion do te sherbeje per te perballuar te gjitha kerkesen per furnizim te 4 blloqeve dhe perspektives se shtimit te popullsise ne 25 vite.

Nga puseta shperndarese ne Rus do te pompohet uji me presion, ne te 4 blloqet nepermjet linjave, perkatesisht:

- Linja L₁ me tubacion DN315mm e cila intersektohet ne bllokun nr.1.
- Linja L₂ me tubacion DN250mm fillon ne nyjen ku shperndahet sasia e nevojshme per bllokun nr.2 prej 7.91 l/s dhe me pas vijon per te furnizuar bllokun nr.3 dhe pjeserisht bllokun nr.1.
- Ndersa L₃ me tubacion DN110mm, fillon ne nyjen ku shperndahet sasia e nevojshme per bllokun nr.3 prej 5.86 l/s dhe me pas perfundon ne puseten fundore qe ploteson bllokun nr.4.

Pergjate hartimit te projektit te detajuar te shikohet mundesia nese skema e furnizimit me uje mund te perfshihet brenda nje sistemi unazor te qytetit.

Per hartimin e ketij projekti duhet te parashikohet qe te furnizohen te gjitha blloqet me sasine e nevojshme te ujit te pijshem, sipas normave perkatese te miratuara.

- Duhet te behet studimi me i detajuar i sasive hyrese dhe dalese ne puseten Rus ne raport me gjitha sistemin.
- Linjat kryesore e dergimit duhet te llogaritet qe te percjellin sasine e ujit te nevojshme per numrin e popullsise ne prespektive sipas te dhenave te instat, te parashikohet qe pas **25 vitesh** te jete ne kushte pune dhe cilesore.
- Puseta ne Rus nga e cila do te furnizohen 4 blloqet e banimit te pajiset me te gjitha elementet qe duhen per te kontrolluar prurjet hyrese, prurjet dalese dhe presionit te duhur te rrjetit.
- Llogaritjet hidraulike te behen qe tubacionet te perballojne kapacitetet faktike dhe te prespektives edhe per rrjetin e brendshem.
- Materialet qe do te perdoren, te jene sipas kushteve teknike te Projektimit dhe te Ndertimit te veprave te kesaj natyre dhe tubacionet dhe rakorderite te jene te certifikara per uje te pijshem dhe konform standarteve Europiane EU.
- Projektuesi duhet te konsultohet vazhdimisht me Shoqërine Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkoder perpara fillimit te punes per projektin, ashtu si edhe ne te gjitha fazat e projektimit dhe te zbatimit te tij dhe kjo si per garantimin e saktësisë se bazes se te dhenave ashtu edhe per reflektimin e ndryshimeve te pritshme.

- Matesat qe do te perdoren duhet te inkorporohen me teknologjine qe kerkon sistemi SCADA ne menyre qe parashikohet edhe mundesia per lidhje me sistemin e monitorimit online te tyre .

Pervec saktetise se te dhenave si me siper, projektuesi, perpara se te filloje punen per projektimin duhet qe paraprakisht:

- 1- Te beje relievin (azhornimin) e te gjithë zones ne studim, te jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
- 2- Te beje skanimin me lidar te rrugëve, zonave ku mendon te shtrinje linjat e sistemit te furnizimit me uje dhe te krijoj ortoimazhet (ortophotot) brenda afatit te fazes se pare.
- 3- Te marre te gjitha azhornimet e rrjetit te infrastruktures (ne bashkepunim me institucionet perkatese);
- 4- Konsulenti duhet te beje verifikimin paraprak ne terren per saktesine e te dhenave/azhornimeve, per rrjetin e infrastruktures, perpara fillimit te projektimit. Kjo duhet ne menyre qe te evitohen pasaktetite gjate projektimit dhe zbatimit, si rezultat i te dhenave te marra qe nuk perputhen me gjendjen ne terren;

Ne baze sa me siper, kerkohet qe Konsulenti te organizoje punen e tij projektuese ne disa faza.

Mbasi te perfundojne azhornimet ne terren, verifikimet si dhe studimet e nevojshme, per te gjithë zonen qe perfshihet ne projekt, projektuesi ben nje analize te shkurter te situates dhe konsultohet me Shoqërine Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkoder, ku merr edhe te dhenat e para mbi ecurine e planeve/studimeve dhe ndikimin e tyre ne projektin e tij.

Projektuesi harton paraprakisht:

Skemen e rrjetit te furnizimit me uje e cila shoqerohet me:

- a) Relacion teknik;
- b) Nje analize te situates ekzistuese, ne raport me efektet sociale qe mund te sjelle projekti ne drejtim te nderhyrjeve te mundshme dhe te elementeve te kosto-efektivitetit dhe te impaktit social, ekonomik, funksionar dhe mjedisor te nderhyrjes.

Qellimi i kesaj faze eshte qe Projekti te kete analize te perputhshmerise me planet, eficencen ekonomike te nderhyrjes, pra efektivitet te koston, minimizim te impakteve negative sociale (si p.sh te prishjeve te panevojshme per kete faze etj.)

- c) Relacion gjeologjik dhe Hidrogeologjik.

Relacioni hidrogeologjik duhet te behet per te garantuar dhe siguruar sasine e ujit ne vazhdimesi, edhe pse burimet jane ekzistues, konsulenti duhet te garnatoj ekzistencen e sasise se nevojshme per uje dhe cilesine e duhur.

d) Hartimi i preventivit:

Llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve të reja ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

e) Standartet dhe normat e projektimit;

Standarte në projektim,

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektimin që parashikon legjislativi në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi duhet të rekomandojë dhe prezantimin e standarteve të reja, për përputhjen me normat e BE-së, si edhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajne elemente të realizueshmërisë me praktiken shqiptare dhe limitimet për financimin e vepres.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kerkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kërket parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislativi në fuqi.

SHERBIMI I LIDHUR ME REALIZIMIN E STUDIM - PROJEKTIMI

Klasifikimi i objektit do të bazohet nëniveleve 34,35,36,37,38,39, të Grupit tarifor III.

VI. DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT

Në realizimin e objektivave për Studim Projektim Rrjeti ujësjellesit të lagjes Mar Lula Shkoder, projektuesi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet të përgatisë sipas nenit 37, të VKM.354, dt 11.05.2016 “*Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit*” sipas fazave të mëposhtme:

- 1. FAZA II - PROJEKT IDE PARAPRAKE**
- 2. FAZA III - PROJEKT-IDEJA PËRFUNDIMTARE**
- 3. FAZA V - PROJEKTIN E ZBATIMIT**
- 4. FAZA VI - PREVENTIVIN PËRFUNDIMTAR**

DETYRAT E DETAJUARA PER KETO TERMA REFERENCE JANE SIPAS FAZAVE

1. FAZA II

Pergatitja e raportit te projekt idese paraprake dhe vizatimet e konceptit ne lidhje me skemen e furnizimit me uje e cila permban (piken e lidhjes, linja kryesore e dergimt, zonat e furnizimit dhe pikat kritike).

Ne kete faze, konsulenti do te pergatise:

- Studimin e topografise i cili perfshine Ortophoton
- Raportin e projekt idese ne lidhje me konceptin dhe gjetjet ne terren;
- Skemen e propozuar ne "GIS" per kalimin e linjave dhe zonave qe do te mbuloj per furnizimin me ujë.
- Skema primare e furnizimit me ujë dhe skemën hidraulike te rigjeneruar nga modeli hidraulik.
- Preventivin fillestar

2. FAZA III,

Projekt ideja përfundimtare duhet të përfshijë minimalisht:

- Raportin teknik te projekt idese perfudimtare, ku perfshihen llogaritjet, studimet, analizat e zgjidhjeve te dhena dhe etj
- Vizatimet e zgjidhjes perfundimtare sipas sipas variantit te propozuar, ku te perfshine minimalisht:
 - Horografia planimetria (1:10'000 ose 1:25'000);
 - Ortophoto planimetria (1:10'000 ose 1:5000);
 - Planimetria e linjes kryesor dhe linjave shperndarese, (bazuar mbi gjendjen ekzistuese ortophot, skanimi dhe rilevimin topografik), (1:1'000);
 - Skema primare e furnizimit me uje;
 - Profili gjatesor i linjes kryesore (1:1000H, 1:200V);
 - Planimetria e pergjithshme ;
- Preventivin;
- Të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor

3. FAZA V + FAZA VI,

Projekti i zbatimit dhe preventivi perfundimtar

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

- **Vizatimet**
 - Horografia planimetria (1:10'000 ose 1:25'000);
 - Ortophoto planimetria (1:10'000 ose 1:5'000);
 - Planimetria e linjes kryesor dhe linjave shperndarese, (bazuar mbi gjendjen ekzistuese dhe rilevimin topografik), (1:1000);
 - Skema primare e furnizimit me uje;
 - Profili gjatesor i linjes kryesore (1:1000H, 1:100V);
 - Planimetria e pergjithshme e pusetave kryesore te kontrollit dhe pusetave shperndarese;
 - Prerje dhe detaje te pusetave
 - Detaje te pikës se lidhjes se rrjetit
 - Detaje te terthoreve tip;
 - Detaje te nyjeve te rrjetit shperndares;
 - Detaje te intersektimeve dhe kalimeve (Tombino, Ura, Kanale, linja elektrike nentokesore dhe kanalizime) ne shkalle te ndryshme;
 - Detaje te pusetave (ajeruse dhe shkarkuese);
- **Relacioni teknik dhe llogaritjet përkatëse ne anekse;**
 - Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në gjendjen egzistuese, jepen llogaritjet hidraulike, llogaritjet e presioneve, llogaritja e veprave te artit, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, modeli kompjuterik i llogaritjeve me GIS dhe Water Gems ose te ngjashme, volumet, llogaritjet hidraulike te rrjeteve te ujësjellësit, etj. Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, studimit gjeologjik, i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve, raporti hidrogjeologjik e hidraulik, etj.
- **Relacioni dhe preventivi i kalimeve te rrugeve dhe carjeve te asfaltit ne rruget nacionale;**

- Jep ne menyre te detajuar dhe te shpjeguar me harta ilustruese, vendet e kalimeve te rruges nacionale (nese ka), menyren nderhyrjes, menaxhimin e trafikut dhe kthimin ne gjendjen fillestare si dhe preventivi i ketyre punimeve;
- **Specifikimet teknike;**
 - Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:
 - Përshkrimi i detajuar i zërit të punës, materialet, cilësia e tyre, etj
 - Metoda e kryerjes së punimeve;
 - Cilësia e kërkuar e punimeve;
 - Formatet e lejuara;
 - Ngjyra e rekomanduar;
 - Njësia e matjes, Etj.
 - Konsulenti duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.
- **Preventivi i punimeve (me dhe pa çmime) si dhe Analizat përkatëse te çmimeve;**
 - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”
 - - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
 - Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zberthimin e çmimit (analizën përkatëse) dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
 - Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e përlogaritur të investimit;
 - Preventivi te shoqërohet me tabelat e volumeve.
- **Grafik punimesh;**
 - Grafiku i punimeve të hartohet bazuar në zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura në Preventiv’
- **Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM)**
 - Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011, VKM 686 29.07.2015 dhe akteve nënligjore përkatëse

VII. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT

Kohëzgjatja e shërbimeve do të jetë 5 (pese) muaj nga data e fillimit.

Nr.	Dokumenti	Dorezimi		Date e perfundimit
		Te printuar	CD	
1	Faza II Projekt ideja paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit) Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit.		1 CD ose email	1 muaj pas lidhjes se kontratës
2	Faza III. Projekt ideja përfundimtare raport (Skema hidraulike përfundimtare planimetri, preventiv, relacione, dokumenta të mbledhura për planifikimin dhe projektim e objektit duke përfshirë të gjitha vizatimet paraprake dhe dokumentacionin)		1 CD ose email	1 muaj pas miratimit te projekt idesë paraprake*
3	Faza V+VI. Projekti i zbatimit final (përfshirë të gjitha vizatimet përfundimtare dhe dokumentacionin, relacionet teknike, specifikimet, Analizën tekniko-ekonomike raportet të përmendura më lart sipas detyrave të përcaktuar në këto terma) + VNM përfundimtare + Preventivi përfundimtar dhe analizat e çmimeve përfundimtare	3 (tre)	1 CD ose email	3 muaj pas miratimit te projekt idesë përfundimtare*

* Ne afate përfshihen dhe koha 1 javore për komentet e klientit dhe për korrigjimet nga konsulenti. **Vizatimet dhe raportet duhet të shtypen në 3(tre) kopje origjinale, në shqip, 1(nje) CD me të gjitha materialet në formatet e editueshme përkatëse (acad, word, excel, etj.) etj.) dhe 1(nje) CD në PDF të firmosur me vule elektronike pas miratimit të projektit të zbatimit.

*Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal ose digjitale nga të gjithë projektuesit.

VIII. MËNYRA E PAGESËS

Pagesa do të kryhet sipas nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 354, dt. 11.05.2016” *"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"* ku:

1. Pagesa duhet të shlyhet, nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, kur shërbimi është kryer konform kontratës dhe është paraqitur tek porositësi një faturë e kontrollueshme.
2. Këstet mund të paguhën në afatet e përcaktuara në kontratë ose në distanca kohore logjike për shërbime të kryera dhe të vërtetueshme.
3. Shpenzimet mbështetëse duhet të paguhën pas paraqitjes së fakteve, nëse nuk është përkufizuar ndryshe në kontratë.
4. Për modalitete të tjera të pagesës duhet të behet dakortesia me shkrim.

Në koston e llogartishme përfshihen kostot e planifikim-projektimit të ***PROJEKT-IDESE PARAPRAKE, PROJEKT-IDESE PERFUNDIMTARE, PROJEKTI I ZBATIMIT DHE PREVENTIVI PËRFUNDIMTAR.***